UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" REKTORATI
Pranuar me dt. 3.7.2023
Nj. org. 01 | Numër 1/570 | Nr.ekzempl. | Vlera

Universiteti i Prizrenit / University of Prizren / Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"
Pranuar me dt. 06.07.2023
Zyra e protokolit 308 | Nr. i protokolit 01-435

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

midis

QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

dhe

QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

I. Përmes kësaj marrëveshjeje për bashkëpunim, të dy qendrat dakordohen për të bashkëpunuar në kuptim akademik dhe profesional me qëllim të dobisë së ndërsjellë duke arritur një marrëveshje më të ngushtë për shkëmbime në fushën e arsimit universitar, trajnimit akademik, hulumtimit/kërkimit shkencor, dhe aktiviteteve tjera në frymën e njëjtë.

II. Duke u mbështetur në statutet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren përbrenda të cilëve funksionojnë qendrat nga kjo marrëveshje, palët pajtohen për të bashkëpunuar në këto fusha:

1. bashkëpunimi dhe bashkërendimi në projektet e përbashkëta ndërkombëtare dhe kombëtare,
2. organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta akademike si janë konferenca akademike, trajnime, kurse të shkurtra trajnuese, seminare dhe simpoziume,
3. organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kërkimore dhe hulumtuese,
4. shkëmbimi i trajnerëve dhe i trajnuesve,
5. shkëmbimi i të dhënave dhe materialeve me interes për të dy palët,

III. Nisma e çfarëdo aktiviteti të veçantë nën këtë marrëveshje bashkëpunimi do të diskutohet dhe dakordohet nga të dy palët para se të niset me çfarëdo programi apo aktiviteti të tillë. Hollësirat e këtyre nismave të veçanta a po marrëveshjeve financiare do të përvijohen në një dokument të ndarë dhe do të nënshkruhen nga zyrtarët e duhur institucional.

IV. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërmjet dy qendrave nuk nënkupton asnjë detyrim financiar.

V. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar nga data e nënshkrimit, ndërsa mund të ndërpritet nga cilado palë me një paralajmërim prej gjashtë muajsh, përderisa nuk dakordohen të dy palët për një ndërprerje të mëhershme.

VI. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe me njoftim të ndërsjell dhe me kohë.

VII. Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje në gjuhën shqipe.

| | |
|---|---|
| Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" | Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren |
| Prof. Dr. Qerim Qerimi<br>Rektor i Universitetit | Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani<br>Rektor i Universitetit |
| Më 3/7/2023 | Më 05/07/2023 |
| v.v. | v.v. |